



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 1211/2014
Datë: 09 shtator 2014

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1.14 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 09 shtator 2014, mori këtë:

V E N D I M

- I. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) të akomodohet në objektin "E" të Pallatit të Drejtësisë, pas përfundimit të renovimeve të nevojshme në këtë objekt, me qëllim të përshtatjes së nevojave dhe specifikave të punës së PSRK-së.
- II. Obligohet Komisioni i Sekretariatit dhe PSRK-së që në bashkëpunim me përfaqësuesit e MAP, KGJK, MD të kërkoj që të ndërmerren veprimet e nevojshme për vendosjen e stafit të PSRK-së sipas pikës I të këtij Vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

A R S Y E T I M

Sipas planifikimit për ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë, është paraparë që prokuroritë të vendosën në objektin C, gjykatat në objektin A dhe B ndërsa Gjykata Kushtetuese në objektin E. Pas hyrjes në fuqi të ligjeve për gjykatat dhe prokuroritë dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial është rritë numri i prokurorëve dhe punonjësve mbështetës, ndërsa reforma e filluar nga 1 janari 2013 parasheh strukturë të re që nuk i përshtatet planifikimit për ndërtimin e objekteve përkatëse në pallatin e Drejtësisë. Duke marr parasysh se objekti E, ka qenë i dizajnuar sipas specifikave të punës së Gjykatës Kushtetuese, tani sipas Vendimit të ri për vendosjen e PSRK-së është e domosdoshme që hapësirat e brendshme të ri-dizajnohen në pajtim me nevojat dhe specifikat e veçanta që ka kjo prokurori. Prandaj, KPK vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Sylë Hoxha
Kryetar i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Anëtarëve në Vendim;
- GP dhe Sekretariatit të ZKPSH;
- Arkivit të PSH-së/KPK-së.